



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2960 Prob

Vlorë, më 29.12.2023

VENDIM

Nr. 19 Datë 27/12/2023

**“PËR NDRYSHIMIN E TARIFËS SË MBETJEVE URBANE TË SHOQËRISË
“BAJKAJ LAND” SH.A.”**

Këshilli i Qarkut Vlorë, në cilësinë e Asamblesë së ortakëve, në mbledhjen e datës ___/___/2023, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9, pika 1.1/b dhe d dhe neni 77, pika 7, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, neni 135, pika 2/c dhe 4, në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Statutit të Shoqërisë "Bajkaj Land" sh.a., shkresën nr. 2057 datë 13.12.2023, "Relacion i Administratorit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a", dhe Vendimin nr. 6 datë 11.12.2023 të Këshillit Mbikqyrës "Për rritjen e tarifës së mbetjeve urbane të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a",

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të tarifës nga 1800 Lekë/ton pa tvsh në 2100 Lekë/ton pa tvsh.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 dt.17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".